



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmje/Prodato Received/Delivery	24.10.2022	viti god year	2
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Itr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHICK	6425/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.788/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.788/2021 të datës 09.09.2022, të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë banimi _____ në Mitrovicë, kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës, në çështjen juridike "kompozim material", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 24.10.2022, një zëri mori këtë

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.788/2022 e datës 09.09.2022 e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, me datë 09.09.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që t'i njihet e drejta e kompensimit në mënyrë retroaktive të diferencës së koeficientit të pagës nga 7.5 në 8.5, duke filluar nga përzgjedhja në pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Projekteve të Zhvillimit Rural" në vitin 2012 deri në Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit të datës 09.08.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 12.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Mitrovicës, ndërsa me datë 27.09.2022 Këshilli ka pranuar shkresat lidhur me këtë çështje administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5288/2022 të datës 09.09.2022 të parashtruar nga _____



ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen me numër të referencës 01-120/08-0076065-0/22 të datës 06.09.2022 të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës; Kërkesën me numër 01-120/0076065/22 të datës 09.08.2022 të parashtruar nga ankuesi ne organin e punësimit; Vendimin me numër A.nr.558/2022 të datës 28.07.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 5328/2022 të datës 12.09.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 5698/2022 të datës 27.09.2022; Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt emërimit me numër A.E.Nr.01-112/01-0075935/22 të datës 09.08.2022; Ndryshim dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit me numër të protokollit 01-112/02-0090956/18 të datës 29.11.2018; Listën e Pagave për muajin Gusht/2022; Vendimin me Nr.01-120/08-0074003/2022 të datës 04.08.2022 të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës lidhur me zbatueshmërinë e vendimit të KPMSHCK-së; Emalin e datës 01.08.2022 të drejtuar Emalin e datës 16.07.2022 të drejtuar

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është parashtruar jashtë afatit ligjor, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesi më datë 09.08.2022 ka parashtruar kërkesë të Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Mitrovicës së Jugut për kompensim të demit në mënyrë retroaktive duke filluar nga përzgjedhja në pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Projekteve të Zhvillimit Rural" në vitin 2012 deri në Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt-it të Emërimit të datës 09.08.2022.

Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Komunës së Mitrovicës së Jugut përmes përgjigjes së datës 06.09.2022, ka njoftuar ankuesin se pretendimin për kompensim retroaktiv të koeficientit nga 7.5 në 8.5 nga vitit 2012 konsiderohet i pabazuar, ndërsa realizimi i koeficientit në 8.5 vlen vetëm pas Vendimit A.nr.538/2022 të datës 28.08.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit ka gjetur së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke vendosur lidhur me ankesën e ankuesit të datës 16.06.2022, me Vendimin A.nr.538/2022 të datës 28.08.2022 ka njohur të drejtën e ankuesit për harmonizimin e koeficientit të pagës nga 7.5 në 8.5, ndërsa përkitazi me pretendimin ankimor të ankuesit për kompensim të demit në mënyrë retroaktive nga data e përzgjedhjes së ankuesit në pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Projekteve të Zhvillimit Rural" në vitin 2012 deri në Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt-it të Emërimit të datës 09.08.2022, Kolegji bazuar në provat e administruara ka konstatuar së në kohën e nënshkrimit të Aktit të Emërimit të datë 15.10.2012 me të cilin ankuesi ishte emëruar *Shef i Sektorit për Zhvillim Rural* ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligji Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, andaj mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se ankesa e parashtruar në Këshill lidhur me pretendimin për kompensim e diferencës se koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive nga data 15.10.2012 është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ku është përcaktuar se: "...Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga

marrëdhënia e punës” si dhe nenin 130 paragrafi 1 të Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative me të cilin përcaktohej se “ Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin; b) akti është shpallur në bazë të dispozitave të këtij Ligji ose ligjeve të tjera në fuqi., kështu që meqenëse ankuesi nga data e nënshkrimit të Akt Emërimit të datës 15.10.2012 e deri me datë 09.09.2022 nuk ka ndërmarr ndonjë veprim juridik në kuptim të kompensimit në mënyrë retroaktive të koeficientit të pagës rrjedh së ankesa e ankuesit A.nr.788/2022 e datës 09.09.2022 është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar edhe me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilin është përcaktuar se: “Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 129 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 788/2022

Avdyl Bekteshi

Bekteshi
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Ardita Haxhnikaj Demi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;